



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT

12.12.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje materiale specifike”

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

44192200-4 Gozhde , 44511000-5 Vegla Dore, 44512300-5 Çekiçe

VLERA E FONDIT LIMIT:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

Fondi limit i procedurës është: 1,249,947 (një milion e dyqind e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e dyzetë e shtatë) lekë pa TVSH.. Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; perkatesisht në vleren 24,998,94 (njëzet e katërmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. 3. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e vlefshme) "Sistemet e menaxhimit të cilësisë" e cila të përfshijë objektin e prokurimit (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO).

Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar Neni 79, pika 1 ku citohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".

Nisur nga përcaktimet e mësipërme në rastin kur ofertuesit paraqesin oferte në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë u vlerësua si e nevojshme që në këtë rast secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë të jetë i pajisur me certifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) pasi këto janë kërkesa që e parashikon legjislacioni në rastin e kualifikimeve që i referohen kualifikimeve të ofertuesit, si dhe është e lidhur ngushtë dhe në proporcion me objektin e prokurimit, pasi kanë lidhje me sigurinë e cilësisë së mallit që do të furnizohet, pra cdonjëri nga anëtarët e bashkimit të shoqërive që merr përsipër të furnizojë në një përqindje të caktuar për këtë objekt prokurimi duhet të disponojë certifikatën e cilësisë së mallit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektivit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro sa 40% e vlerës së fondit limit, njësjë e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar– Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", dhe Kreu II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësjë e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësjë e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në korrik të vitit 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 të ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika ”c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates me vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe konkretisht: 249.989.4 (dyqind e dyzet e nënëtmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë katër) lekë pa tvsh.Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është

kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllorarit të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresën e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor

2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë nga administratori i shoqërisë ku të deklarojë se materialet janë të reja, të papërdorura, pa defekte dhe sipas sasisë dhe specifikave teknike të përshkruara nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikimet teknike për çdo produkt:

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK nga struktura të specializuara/ Grupi I punës ngritur me Urdher të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Nr.711, datë 10.09.2024 ka hartuar specifikimet teknike për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo reference duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nr.	Përshkrimi/Specifikime	Njësia	Sasia
1	Çekiç guri me ane katrore '1500gr (vare e vogël / profesionale) (mundëson ndarjen dhe goditjen e materialeve të forta si guri dhe betoni)	copë	2
2	Çekiç mekanik '1000gr, me bisht druri (mundëson ndërtim dhe mirëmbajtje mekanike, bishti I drurit e bën më të lehtë në përdorim)	copë	2

3	Morsete per saldatrice (-) (mundëson qëndrueshmërine e materialeve gjatë saldimit)	copë	1
4	Pince per saldatrice (+) (mundeson mbajtjen në vend të materialeve gjatë saldimit)	copë	3
5	Perparese lekure per saldim (profesionale) (mundeson ruajtjen ndaj nxehtesise)	copë	2
6	Xham saldimi '50x110, din 9, 10, 11 (mundeson mrojtjen e fytyres gjate saldimit)	copë	6
7	Baraban (zgjatues) me kabell '3x2.5 (50ml) (mundeson lidhjen e energjise elektrike me zgjatues)	copë	4
8	Celes fiso-stel kriket '13mm (chrome-vanadium)	copë	3
9	Celes fiso-stel kriket '17mm (chrome-vanadium)	copë	3
10	Celes fiso-stel kriket '19mm (chrome-vanadium)	copë	3
11	Adaptor per kriket, per koka 1/4 'femer (i vogel)	copë	3
12	Set çelësa 'ekzagon 'm/4-12 (vanadium/profesionale)	set	2
13	Set çelësa 'ekzagon '4-12mm (forme L)	set	2
14	Set çelësa 'ylle 4-12mm (forme L)	set	2
15	Set çelësa 'ylle 4-12 (vanadium/profesionale)	set	2
16	Set maja: kryq, drejt, ekzagon, yll, yll me vrime, shlice, etj (100pc)	set	2
17	Kacavide mekanike me maje te sheshte '250mm (profesionale)	copë	4
18	Kacavide mekanike me maje kryq '250mm (profesionale)	copë	4
19	Kacavide mekanike per maja te 'kembyeshme (profesionale)	copë	4
20	Maja kacavide 'PH2-SL5mm, me dy ane + dhe - (profesionale)	copë	15
21	Maja kaçavide 'kryq PH1 (temperuar/profesionale)	copë	15

22	Maja kaçavide 'kryq PH2 (temperuar/profesionale)	copë	15
23	Maja kaçavide 'kryq PH3 (temperuar/profesionale)	copë	15
24	Thika me lama te kembyeshme '18mm, me doreze metalike (prof.)	copë	2
25	Lama per thika (10pc) (mundeson prerjen e materialeve)	copë	4
26	Disk per prerje metali '355x3x25.4mm (per sharre bangoje)	copë	1
27	Disk per prerje druri '300x2.6x25.4mm (per sharre bangoje)	copë	1
28	Disk hekuri per fresibel '230x3x22.2mm (i madh)	copë	50
29	Disk hekuri per fresibel '115x2.5x22.2mm (i vogel)	copë	25
30	Disk druri per fresibel '230x2.6x22.2mm (i madh)	copë	2
31	Disk druri per fresibel '125x2x22.2 mm (i vogel)	copë	2
32	Disk i 'dhembeuar per gerryerje druri '125x2-30x22.2 (carving disc)	copë	1
33	Disk axhustimi per metale '115x22.2mm (i vogel) (mundeson perpunimin e metaleve)	copë	15
34	Disk diamanti per beton '230x2x22.2	copë	4
35	Gure dore per mprehese thikash '20x4x2cm (forme drejtekendore)	copë	1
36	Silikon betoni me dy komponente, tub 300ml	copë	5
37	Silikon ngjites universal, tubet 50ml	copë	10
38	Defkon ngjites per metale/plastik, me dy komponent	copë	15
39	Shkume universale per mbushje, 600 ml, tub me doreze	copë	5
40	Pastrues grafitesh solucion (profesional)	copë	25
41	Mentesha per dyer metalike, gjatesi '140mm	copë	20
42	Goma per karroca dore (goma 'mishi/verdh) profesionale	copë	1
43	Doreza pune 'Lekure+tekstil (profesionale)	copë	50

44	Tel bari '1,2mm (mundeson perforcimin e strukturave)	kg	100
45	Fasheta plastike '4.8x360mm (100pc)	pako	10
46	Gozhde '8cm	kg	6
47	Shirit sinjalizues per kantiere (t.180ml)	pako	20
48	Punto druri '12x400mm	copë	2
49	Punto hekuri '4mm (cobalt)	copë	10
50	Punto hekuri '5mm (cobalt)	copë	10
51	Punto hekuri '6mm (cobalt)	copë	10
52	Punto hekuri '8mm (cobalt)	copë	10
53	Punto hekuri '10mm (cobalt)	copë	10
54	Punto hekuri '12mm (cobalt)	copë	10
55	Set me punto axhustimi per dru	set	1
56	Set punto druri drejt '18-26mm	set	2
57	Vida '8x80mm	copë	400
58	Vida druri '8x80 me koke konike (+)	copë	300
59	Upa '10mm	copë	300
60	Rondele '8-16	copë	100
61	Rondele '10-20	copë	100
62	Rondele '12-24	copë	100
63	Dado me gomine M10	copë	20
64	Dado me gomine M12	copë	20
65	Vida vetefiletuese me koke ekzagonale '6x80mm	copë	301
66	Prixhioner M12 (1ml)	ml	30
67	Prixhioner M10 (1ml)	ml	30
68	Boje Akrilik per beton (ambjente te jashtme)	litra	150
69	Boje vaji me ngjyra të ndryshme	litra	200
70	Pigment boje akriliku per beton (ambjente te jashtme), me ngjyra: zeza,kuqe,jeshile,blu,kafe,verdh,oker.	litra	55
71	Sprai, boje e bardh	copë	50
72	Llak per lyerjen e materialit dru	kuti	130
73	Antiruxhio (mundeson parandalimin e ndryshkjes se hekurit)	litra	50
74	Rul per lyerje '12cm (me qeleshe/profesionale)	copë	30
75	Furce papagall '6cm, me bisht te kthyeshem (artikulacion)	copë	20
76	Furce papagall '10cm, me bisht te kthyeshem	copë	20
77	Furçe teli dore (me bisht)	copë	2
78	Spatul me bisht druri '6cm	copë	5

79	Spatul me bisht druri '8cm	copë	5
80	Spatul me bisht druri '10cm	copë	5
81	Leter zmerile '40, tekstil shirit	copë	60
82	Leter zmerile '80, tekstil shirit	copë	60
83	Koke (tampon) per zmerile letre me ngjitje per fresibel '125	copë	4
84	Leter zmerile per tampon (me ngjitje/rrethore) per fresibel '125	copë	50
85	Tenie letre '3cm (per izolime boje)	copë	9

Afatet e lëvrimit: Afati i lëvrimit do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Specifikimet teknike

- Materialet duhet të përmbushin specifikimet që kanë në emërtimin e tyre.
- Për Artikullin Nr . 7 , barabani duhet të ketë minimumi tre hapësira për vendosjen e prizave.
- Për Artikullin Nr. 16, seti duhet të përmbaj 100 copë.
- Për Artikullin Nr. 25, paketimi duhet të përmbaj 10 copë.
- Për Artikullin Nr. 70, duhet të vendosen në dispozicion të AK-së të gjitha ngjyrat e kërkuara.
- Mallrat duhet të jenë të reja, të papërdorura më përpara, si dhe të padëmtuara.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmartje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj".